

Profet, Mesues i Moralit apo Krye Engjull

Disa njerëz të cilët nuk e pranojnë Jezusin sikur Zot do thonë shpesh here që Jezusi është vetëm një mesues i madh i moralit, një profet ose mbase edhe një krye-engjull.

Jezusi nuk mund të jetë asnjëri nga të lartpërmendurit, si autor dhe profesor i Universitetit të Kembrixhit Dr. C.S. Lewis shkroj në librin e tij Mere Christianity – Krishtërimi i thjeshtë:

"Një njeri që ka qenë vetëm një njeri dhe ka thënë gjëra që Jezusi tha, nuk do të ishte një mesues i moralit... Ai ose do ishte i çmendur ose do ishte Dreqi i ferrit."

- Si mund Jezusi të ishte një mesues i moralit apo profet i Perëndisë nëse me qëllim gënjeu për identitetin e Tij ?
- Si mund të ishte një njeri i shenjtë apo krye engjull dhe ti lejonte njerzit që ta adhuronin Atë në Tokë dhe në Qiejll ?
- Ose si mund një njeri besimtar apo engjull t' u thojë njerzve që ata duhej besuar në Atë dhe Përendin për Shpëtim ?
- Si mund një njeri apo engjull vetëm pa Perëndin mund t' u ipte atyre jetën e përjetshme ?
- Si mund një besimtar apo engjull të deklaroj titujt, tiparet dhe funksionet e Perëndisë ?

Secili duhet të bëjë një zgjedhje se kush është Jezusi. Jezusi mund të jetë një gënjeshhtar, i çmendur, satan... ose Zoti!

Kush thoni ju se Jezusi ishte ?

*Zgjedh me mençuri. Përfjetaria jotë varet prej zgjedhjeve tuaja.
(Gjoni 3 :16 ; 3 :36 ; Veprat e Apostujve 4 :12)*

Translated:(Përkthyer nga Agon Dahsyla)

JEZUSI ËSHTË ZOTI

Provat Biblike



Sikur një djalë 8 vjeçar nga Filadelfia Jugore, Unë rashë në dashuri me Zotin, Atin tim Qiellor.

Unë kurrë nuk e kuptova se pse Jezusi duhej të ishte Perëndia kur Ati ishte Perëndia që unë kisha nevojë. Unë e dija që Jezusi ishte i Biri i Perëndis, por kurrë nuk kam menduar se Ai ishte plotësisht Ai.

Disa vjet më vonë, lexova në Bibël që Jezusi dhe Bibla deklarimin teori të plotë për Jezusin! Provat biblike që unë gjeta që Jezusi është Perëndia janë të shkuara në këtë fletushkë. Le ta ndryshoj jetën tuaj sikur e ndryshoj timën
~~~ Pastor Bob

## **Pse është kjo kaq e rëndësishme?**

"... sepse po të mos besoni se Unë Jam, ju do të vdisni në mëkatet tuaja." ~ Jezusi (Gjoni 8:24)

- Teoria e plotë e Jezusit nuk është e pranuar nga religjionet jo-krishtere. Disa të krishterë edhe e dyshojnë.
- Shpëtimi i të gjithëve varet nga lidhja e tyre me Jezusin~~~jo thjesht me mësimet e Tij. **Ati Perëndi dhe Jezusi deklaruan besim në Jezusin për shpëtim** (Gjoni 3:16, 3:36, Veprat e Apostujve 4:12)
- Nese nuk e shohim ne **Jezusin sikur Zotin** ateher ka mundesi gjithashtu të mos i bindemi fjalëve të Tij ne Bibel.
- Duke shikuar se çfarë Jezusi deklaronte per veten e tij, **Jezusi mund te ishte nje gjeneshitar, i çmendur, një djall ose Zoti!**
- Perëndia do qe ndjekësit e Tij të jenë në gjendje ta shpjegojne te tjerëve besimin e tyre ne Jezusin:  
"Madje shenjëtori Zotin Perëndinë në zemrat tuaja dhe **jini gjithnjë gat për t'u përgjigjur** në mbrojtjen tuaj kujdo që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju, por me butësi e me druajtje." (1 Pjetrit 3:15)

## **Jezusi foli sikur të ishte Perëndia**

- **Jezusi deklaroi unitet me Atin Perëndi:** (Gjoni 10:30-33):  
"Unë dhe Ati jemi një! Prandaj Judentë morën përsëri gurë për ta vrazë me gurë... Judentë u përgjigën duke thënë, 'he nuk të vrasim me gurë për asnjë vepër të mirë, po për blasfemi, dhe sepse Ti, duke qenë njeri, e bën veten Perëndi.'"  
Judentë provuan ta vrisnin Jezusin sepse Ai tha "që Perëndia ishte Ati i Tij, **duke e bërë Vetën të barabartë me Perëndin.**" (Gjoni 5 :17-18)
- **Jezusi deklaroi emrin e Shenjtë të Perëndis :** "Jezusi u tha atyre: 'Në të vërtetë, në të vërtetë unë po ju them: para se të kishite lindur Abrahami, 'Unë Jam.' Atëherë ata morën gurë, që t'i hidhnin kundër Tij...' (Gjoni 8 :58-59)  
"Unë Jam" është emër i shenjtë për Perëndin tek Eksodi 3:14. Të gjithë Judentë e ditën atë dhe nese dikush do e përdorte do vritej me gurë.
- **Jezusi thotë që besimi në Të jep Jetën e Përhjetshme:** "... dhe unë i jap atyre jetën e përjetshme dhe nuk do të humbasin kurrë..." (Gjoni 10:28)  
"Dhe ai që...beson në Mua, nuk do të vdesë kurrë përjetë." (Gjoni 11:26)
- "Besoni në Perëndin, poashtu besoni dhe në Mua." (Gjoni 14:1)  
Jezusi u mësoj atë "...që të gjithë ta ndërojnë Birin ashtu siç **ndërojnë Atin.**" (Gjoni 5:23)
- "...Ai[Frymja] do ta bindë botën... sepse nuk besojnë në **Mua...**" (Gjoni 16:8-9)
- "... sepse po të mos besoni se Unë Jam, **ju do të vdisni në mëkatet tuaja.**" (Gjoni 8:24)
- "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje." (Gjoni 14:6)

## Jezusi ka Tipare, Funkcionet dhe Tituj e Perëndis (Vazhdimi)

- **Perëndia dhe Jezusi hakmerren kundër të ligës.** "Mos u hakmerri për veten tuaj, o të dashur, por i jepni vend zemërimit të Perëndisë, sepse është shkrua, 'Mua më përket hakmarrja, unë kam për të shpëgjuar', thotë Zoti.'" (Romakëve 12:19)
- "Gjykimi i drejtë i Perëndis (2 Thesalonikasëve 1:5) do të mbahet në fund të kohës" ... "kur Zoti Jezus Krisht të shfaqet nga qielli me engjëjt e pushtetit të vet, në një zjarr flakërues, për t'u hakmarrë kundër atyre që nuk njohin Perëndi, dhe të atyre që nuk i binden ungjillit të Zotit tonë Jezu Krisht..." (2 Thesalonikasëve 1:7-8) *Engjëjt e kujt??*
- **Perëndia dhe Jezusi deklarojnë titullin e Shpëtimtarit:** "Unë... unë jam Zoti dhe përveç meje nuk ka Shpëtimtar tjetër." (Isaia 43:11)
- "Pali, apostulli i Jezus Krishtit, me urdhër të Perëndisë, Shpëtimtarit tonë, dhe të Zotit Jezu Krisht, siprësës sonë..." (1 Timoteut 1:1)
- **"Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht..."** (2 Pjetrit 1:11)
- "...me urdhër të Perëndisë, Shpëtimtarit tonë...hir, mëshirë dhe paqe prej Perëndisë, Atit, dhe prej Zotit Jezu Krisht, Shpëtimtarit tonë." (Titit 1:3-4)

*Shikoni se sin e keto dy vargjet e njëpasnjëshme (Titit 1:3-4), Perëndia Ati u quajtë Shpëtimtar dhe Jezusi u quajtë Shpëtimtar.*

*Perëndia Ati u quajtë Shpëtimtar 13 herë në Testamentin e Vjetër. Perëndia dhe Jezusi u quajtën Shpëtimtar 24 herë në Testamentin e Ri. Nga njëherë Ati u quajtë Shpëtimtar dhe nganjëherë Jezusi u quajtë Shpëtimtar*

## Persëritja që ja vlen Shpëtimit i të gjithëve varet se si janë ata të lidhur me Jezusin

- Perëndia Ati dergoi Jezusin që kushdo që beson në Jezusin ka jetë të përjetshme:
  - "Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme." (Gjoni 3 :16)
  - "**Kush beson në Birin** ka jetë të përjetshme, kurse kush nuk i bindet **Birit** nuk do të shohë jetë, por zemërimi i Perëndisë qëndron mbi të." (Gjoni 3 :36)
- Asnjë profet apo mesues smund apo sduhet të bëjë këto lloj deklaratash. Për një njeri këto deklaratë do ishin blasfemi kundër Zotit. Jezusi ishte kryqëzuar se kishte thënë këto deklaratë (Marku 14:61-65)
- **Jezusi gjithashtu deklaroi që besimi në Të është e vetmja rrugë për tek Ati:** "Jezusi i tha: "Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje." (Gjoni 14:6)
- Meqe po flasim për Jezusin, Apostulli Luka shkroi: "Dhe në asnjë tjetër nuk ka shpëtim, sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohemi" (Veprat e Apostujve 4:12)
- **Nese nuk e shohim në Jezusin sikur Zotin ateher ka mundesi gjithashtu të mos i bindemi fjalëve të Tij në Bibël, ...që të gjithë ta nderojnë Birin ashtu siç nderojnë Atin; kush nuk e nderon Birin, nuk nderon Atin që e ka dërguar. (Gjoni 5:23)**

## Provat Biblike

Kur e tëra është thënë dhe bërë, provat biblike për hyjnim e Jezusit janë të shumta!

Në realitet, hyjnia e Jezusit mund të justifikohet biblikisht vetem nga kjo pika e pare: Jezusi e pranoi adhurimin e Hebrenjëve në tokë dhe të engjujve në qiell.

### Provat Biblike janë:

|                                                             |                                                                                       |
|-------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| Jezusi pranoi adhurimin nga njëzëit në tokë                 | Në Qiell, Jezusi është adhuruar nga engjëjt dhe pleqtë dhe të gjitha qeniet e gjalla. |
| Jezusi pohon atributet e Atit Përendi Funksionet dhe Titujt | Në Bibël Jezusi thirret aktualisht Përendia                                           |
| Jezusi ishte dhe ai foili sikur të ishte Zoti               |                                                                                       |

## Jezusi ka Tiparet, Funksionet dhe Titujt e Perëndis

**Jezusi krijoi gjithëçka për vete:** "Sepse në Të u krijuan të gjitha gjërat, ato që janë në qiejt dhe ato mbi dhe, gjërat që duken dhe ato që nuk dukem...; të gjitha gjërat janë krijuar me anë të Tij dhe në lidhje me Të." (Kolozianëve 1:16) *Vetëm Përendia krijoi gjithëçka për vete.*

**"Të gjitha gjërat u bënë me anë të Tij (Fjala); dhe pa Atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë."** (Gjoni 1:3)

**Jezusi ka çdo autoritet:** "Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë" (Mateu 28:18)

**Jezusi fal mëkatën:** "Ai i tha paralitikut: 'Merr zemër, o bir, mëkatet e tua të janë falur!' Atëherë disa shkribë thanë me vete, 'Ky po blasfemion!'." (Mateu 9:1-3) *Vetëm Përendia fal mëkatën.*

**Jezusi shpëton njëzëit nga mëkati:** "Dhe ajo do të lindë një djalë, ...Jezus, sepse Ai do të shpëtojë popullin e Tij nga mëkatet e tyre." (Mateu 1:21) *Vetëm Përendia mund ta bëjë atë.*

"... Të nesërmen, Gjoni e pa Jezusin që po vinte drejt tij dhe tha: **'Ja, Qengji i Perëndisë, që heq mëkatin e botës!'**" (Gjoni 1:29)

"Prandaj edhe **mund të shpëtojë plotësisht** ata që me anë të Tij i afrohen Perëndisë, sepse gjithmonë iron që të ndërmjetojë për ta." (Hebrenjëve 7:25)

**Jezusi dhe Ati deklarojnë titullin Alfa dhe Omega "I Pari dhe I Fundit":** "Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi,' thotë Zoti "që është dhe që ishte dhe që vjen, i Plotfuqishmi.'" (Zbulesa 1:8)

"Dhe ja, **unë vij shpejt**.... Unë jam Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi, i pari dhe i fundit." (Zbulesa 22:12-13) *Vetëm Jezusi do vij së shpejti!*

## Jezusi u quajte Zot në Bibël

"Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi." (Gjoni 1:1)

"Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne..." (Gjoni 1:14)

"Kini në ju po atë ndjenjë që ishte në Jezu Krishtin, i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabart me Perëndinë, por e zbrazti veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit..." (Filipianeve 2:5-7)

"Sepse tek Ai banon trupërisht gjithë plotësia e Hyjnisë." (Kolozianëve 2:9)

Duke folur për Jezusin në lidhje me Atin, Hebrejëve 1:3 thotë, "Ai, duke qenë shkëlqimi i lavdisë së Tij [Atit] dhe vula e qentes së Tij dhe duke i mbajtur të gjitha me fjalën e fuqisë së Tij."

"Kurse për engjëjt thotë, 'Engjëjt e Vet Ai i bën erëtra, dhe shërbenjësit e Tij flakë zjarr', ndërsa për të Birin thotë, 'Froni yt, o Perëndi është në shekuj të shekujve; skeptri i mbretërisë sate është skeptër drejtësie.'" (Hebrejëve 1:7-8)

"...Sepse na ka lindur një fëmijë... dhe do të quhet... Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Prince i paqes." (Isaia 9:6)

"Ja, virgjëresha do të mbetet shtatzënë dhe do të lindë një djalë, të cilit do t'i venë emrin Emanuel, që do të thotë: 'Zoti me ne.'" (Mateu 1:23)

## Adhurimi i Tjerëve përveq Zotit është Gabim

Sipas Biblës, vetëm Zoti i Plotfuqishëm është i denjë për tu adhuruar nga cilido në tokë apo në qiell. E para nga 10 Urdhëresat e ngulon këtë idhujtari. Zoti shkatroj kombe të tërë, duke përfshirë Izraelin e Tij të dashur pasiçë bestuan në zotra falso.

Kur Apostulli Pjetër hyri në shtëpin e Kornelit për ta takuar tek Veprat 10, Kornel "ra në gjunjë dhe e adhuroj atë, Por Pjetri e ngriti duke thënë: 'Çohu, edhe unë jam një njeri!'" (Veprat e Apostujve 10:24-26)


Kur Apostulli Gjoni u ndje i mbushur me zbulësat që ai po merrte në qtell nga engjulli që po e drejtonte, Gjoni shkroi, "**Rashë për ta adhuruar** përpara këmbëve të engjëllit që m'i tregonte këto gjëra. Dhe ai më tha: 'Ruaju se e bën! Sepse unë jam bashkëshërbëtori yt dhe i vëllezërve të tu, profetë, dhe të atyre që i ruajnë fjalët e këtij libri. Adhuro Perëndinë!'" (Zbulesa 22:8-9)

Gjoni bëri të njejtën gjë prap tek Zbulesa 19:10 dhe engjulli i tha prap te njejtën gjë: "Ruaju se e bën! Adhuro Perëndinë!"

**Sidoqoftë, ndërsa ishte në tokë dhe në qiell, Jezusi pranon adhurimin e njerzve dhe engjujve.**

*Duke bërë këtë nënkuptohet që Jezusi ose është Zoti ose Ai është një përson i lig në pamjen e Zoti*

Le të shikojme Provat Biblike:



## Jezusi Pranon Adhurimin e Njerzve Në Tokë

- **Nga Apostujt e Tij:** "Atëherë ata që ishin në barkë erdhën dhe e **adhuruan**, duke thënë, "Me të vërtetë ti je Biri i Perëndisë!". (Mateu 14:33)
  - "Dhe ja Jezusi u doli përpara dhe tha... "Tungjatjeta!". Atëherë ato u afruan, i trokën këmbët dhe e **adhuruan Atë**" (Mateu 28:9)
  - "Ku rata e panë Atë, **ata e adhuruan Atë**..." (Mateu 28:17)
  - Dishepujt e tij, "**pasiqë e adhuruan Atë**, u kthyen në Jeruzalem ..." (Luka 24:52)
  - Thomai e quajti Atë Zot: "Pastaj i tha Thomait: 'mos jji mosbesues, por besues.' Thomai u përgjigj dhe i tha, "**Zoti im dhe Perëndia im!**". (Luka 20:27-29)
- Kujtojeni që këta ishin njerzit që jetuan me Jezusin për 3 vjet dhe e shikuan Atë duke vdekur. **Nëse Jezusi do ishte vetëm një njeri, ata do e dinin!**
- **Nga një njeri i shëruar:** "Dhe ai tha, 'Zot, Un besoj.' Dhe e adhuroj Atë." (Gjoni 9:38)

Një Hebre i mirë kurë sdo e lejonte aske ta adhuronte ate. *Ai mund të ishte mbytur me gurë për blafëmi*-duke deklaruar që është hyjnor.

- **Nga shkenctarët pagan:** Dijetarë e panë yllin e Tij dhe udhëtuau gjatë që "ta adhuronin Atë" (Mateu 2:2). Më vonë kur e gjetën Atë "ranë përmbys dhe e **adhuruan**." (Mateu 2:11)

**Nëse Jezusi nuk është Zoti dhe Ai i lejon njerëzit ta adhurojnë Atë,**

**Ai duhet të jetë një gënjeshtar, i krisur apo një satan nga ferri,**  
**- ose të gjitha nga më lart**

## Jezusi adhurohet

### nga engjujt dhe dhjakët në parajsë

Meqë po flasim për ardhjen e dytë të Jezusit, Hebrenjtë 1 :6 thotë,  
"Dhe kur Ai e dërgon prap të Parëindurin në botë. Ai thotë 'DHE ATË LE TA ADHUROJNË ENGUJTE ZOTIT.'"

"Pastaj pashtë, dhe dëgjova zërin e shumë engjëjve përqark fronit, qenieve të gjalla dhe **pleqve** ; dhe numri i tyre ishte dhjetë mijëra dhjetë mijërash dhe mijëra mijërash, që thoshnin me zë të madh : "**I denjë është Qengji** që u ther, të marrë fuqinë, dhe pasurinë, dhe diturinë, dhe forcën, dhe nderin, dhe **lavdinë, dhe bekimin**." (Zbulesa 5 :11-12)

"Edhe dëgjova **çdo krijesë** që është në qiell, mbi dhe, nën dhe dhe ato që janë në det dhe gjitha gjërat sa janë në to, që thoshnin, '**Atij që rri ulur mbi tron dhe Qengjit i** qofshin bekimi, nderi, lavdia dhe forca në shekuj të shekujve.' Dhe të katër qeniet e gjalla thoshnin, 'Amen.' Dhe të njëzet e katër **pleq ranë përmbys dhe adhuruan Atë** që rron në shekuj të shekujve." (Zbulesa 5:13-14)

Shikoni si **nuk ka dallim adhurimi** ndërjmjet asaj që i dhurohet Atit Perëndi dhe Jezusit Qengjit. **Të gjitha gjërat e krijuara e adhurojnë të pakrijshëm Perëndi, Ati dhe Biri.**

"Dhe frymërat e ndyrë, kur e shihnin, **binin përmbys para Tij** dhe bërtinin, duke thënë, 'Ti je Biri i Perëndisë !'" (Marku 3 :11)

*Në Bibël nuk thuhet që demonët bien në gjunjë para një personi që i përze ata.*

"Dhe ja, ata filluan të bërtasin duke thënë, 'Ç'është mes nesh dhe ty, Jezus, Biri i Perëndisë?' **Mos ke ardhur këtu të na mundosh para kohe?'**" (Mateu 8:29)

*Kush përveq Zotit mund t'i torturoj demonët në fund të fundit?*